



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 13/f Prot., Datë 25/01/2012

MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 6309/f Prot., Datë 09/01/2012
8

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

MINISTRISË SË DREJTËSISË

DHE

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Ministria e Drejtësisë dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (të quajtura në vijim “Palë”):

Duke vlerësuar rëndësinë e promovimit, garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe mekanizmave ligjorë zbatues të tij;

Duke u angazhuar për marrjen përsipër për sigurimin e të gjithave mjeteve të nevojshme për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Duke konsideruar si domosdoshmëri ushtrimin e ndërsjelltë të veprimtarisë institucionale me qëllim realizimin e interesave të ligjshëm të personave mbështetur në parimin e barazisë përpara ligjit, dhe parimin e barazisë së shanseve e mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë:

Duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi që rregullon edhe veprimtarinë tyre institucionale e administrative të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim “Memorandum”).

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Bashkëpunimi, është bashkërendimi i ndërsjelltë reciprok i veprimtarisë institucionale të punës midis Komisionerit të Mbrojtjes nga Diskriminimi dhe Ministrisë së Drejtësisë e strukturave të varësisë së saj, me qëllim ndjekjen, kujdesjen, garantimin, ofrimin e shërbimeve cilësore duke marrë në konsideratë realizimin e interesit më të lartë të qytetarit, për marrjen pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjelleje që nxit diskriminimin, në funksion të respektimit dhe zbatimit të Kushtetutës, Ligjit nr. 10 221 datë, 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

Bashkëpunimi i ndërsjelltë realizohet nëpërmjet formave:

1. Bashkërendimit për realizimin e politikës e veprimtarisë së përgjithshme shtetërore, përfaqshjen e integrimin në fushën e sistemit të drejtësisë në nismat e strukturat ndërkombëtare për çështjet e diskriminimit;
2. Bashkëpunimit nëpërmjet ofrimit të dhënies së asistencës ligjore në hartimin e projekteve të akteve ligjore e nënligjore, në funksion të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian e shteteve anëtare të tij, dhënies së mendimit të specializuar juridik për projektaktet ligjore e nënligjore, si dhe projekt marrëveshjeve ndërkombëtare që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave për çështjet që lidhen me diskriminimin.
3. Pjesëmarrjes në grupet e punës për dhënien e analizës ligjore në legjislacionin ekzistues, me qëllim marrjes së masave për garantimin e trajtimit të barabartë të personave dhe parandalimit të formave të diskriminimit.
4. Garantimit sipas legjislacionit në fuqi, për ofrimin e shërbimeve juridike-administrative që lidhen me sistemin e drejtësisë por sipas rastit për çështjet e diskriminimit.
5. Nxitjes e kujdesjes për realizimin e bashkërendimit të veprimtarisë në fushën e drejtësisë për të mitur, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor, dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit, shërbimin ndaj të miturve nga strukturat përgjegjëse të sistemit të drejtësisë për çështjet e diskriminimit.
6. Shmangjes së diskriminimit të personave, të cilët mbulohen nga marrëveshjet dypalëshe, në fushën penale, civile dhe tregtare në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, si dhe me organizma ndërkombëtarë.
7. Mbështetjes për përgatitjen profesionale, nëpërmjet trajnimit, aftësimit e specializimit e juristëve të administratës publike, gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, noterëve, arbitrit, ndërmjetësit, administratorit të falimentimit dhe profesioneve të tjera të lira që lidhen me sistemin e drejtësisë, si dhe punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe i gjithë sistemi penitenciar, Shërbimi Përmbarrimor Shtetëror, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Komitetin Shqiptar të Birësimeve, Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Institutit të Integritetit të të Përndjekurve, Shërbimit të Provës, Institutit të Mjekësisë Ligjore, si dhe avokatët e shtetit për çështjet e diskriminimit.

8. Nxitjes e marrjes së masave për mbështetjen e veprimtarive shkencore dhe përhapjes së edukatës juridike në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.
9. Ndjekjes dhe bashkërendimit të marrëdhënieve me shoqërinë civile në fushën e drejtësisë për çështjet e diskriminimit.
10. Marrjes së masave për evidentimin dhe parandalimin e diskriminimit apo çdo forme sjelljeje tjetër që nxit diskriminimin edhe në strukturat e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë, si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe i gjithë sistemi penitenciar, Shërbimi Përmbartimor Shtetëror, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Instituti i Integritimit të të Përndjekurve, Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Shërbimi i Provës.
11. Shkëmbimit të përbashkët të statistikave për numrin e rasteve të raportuara për çështjet e diskriminimit si edhe me institucionet e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim studimin, analizimin, marrjen e masave për hartimin e dokumentave strategjike për përmirësimin e mbrojtjes në mënyrë efektive nga diskriminimi.
12. Bashkëpunimit edhe nëpërmjet formave të tjera për të cilat palët mund të bien dakord në të ardhmen.

Neni 3

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve

1. Palët shkëmbejnë midis tyre informacionin e nevojshëm me qëllim marrjen e masave për realizimin e zbatimit e këtij memorandumi, evidentimin e problematikave dhe përmirësimin e politikave të diskriminimit.
2. Në zbatim të rregullit të sipërcituar, në pikën 1 të këtij neni, palët vendosin me vullnetin e dëshirën e tyre që mënyra e shkëmbimit të informacionit reciprok të punëve midis tyre, të jetë në formën shkresore, me përjashtim të rasteve urgjente ku forma e koordinimit dhe shkëmbimit të punëve realizohet nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar.

Neni 4

Caktimi i personit përgjegjës

1. Palët caktojnë personin përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të këtij memorandumi.
2. Në rast se personi përgjegjës, i secilës prej palëve të interesuara, konstaton mosrepektimin apo moszbatimin e këtij memorandumi, raporton tek titullari i institucionit përgjegjës me qëllim marrjen e masave edhe në vijueshmëri për përmirësimin e këtij memorandumi në kuadër të legjislacionit në fuqi apo rekomandimeve ndërkombëtare.
3. Palët, komunikojnë midis tyre me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 5

Ndryshimi në përmbajtjen e memorandumit

1. Ndryshimi në përmbajtjen e këtij memorandumi bëhet me dëshirën e vullnetin e palëve duke marrë në konsideratë interesat e ligjshëm të personave për mbrojtjen në mënyrë efektive nga diskriminimi apo çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

2. Mënyra e paraqitjes së propozimeve për ndryshime në përmbajtjen e këtij memorandumi realizohet me shkrim në rrugë zyrtare, me anë të së cilit përcaktohet edhe afati kohor i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara të secilës prej palëve.
3. Në rast se konstatohen mosmarrëveshje ose keqkuptime në zbatimin e këtij memorandumi, ndryshimi i tij realizohet vetëm nëpërmjet konsensusit dhe mirëkuptimit të palëve.

Neni 6

Përfundimi i memorandumit

1. Palët lidhin Memorandumin Bashkëpunimi pa caktuar ndonjë afat konkret për përfundimin e tij, i cili mund të përfundojë në çdo kohë.
2. Duke u bazuar në rregullin e sipërcituar, në pikën 1 të këtij neni, palët detyrohen midis tyre të njoftojnë me shkrim në rrugë zyrtare për përfundimin e këtij memorandumi, i cili hyn në fuqi 30 ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.
3. Palët detyrohen që përpara datës së përfundimit të këtij Memorandumi të realizojnë të gjitha kushtet e detyrimet që rrjedhin nga ky Memorandum.

Neni 7

Hyrja në fuqi

1. Memorandum i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përgatitet në gjuhën shqipe, e nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Ministrinë Drejtësisë dhe dy të tjera në Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.
2. Memorandumi Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkruhet në Tiranë, më datë 25/01/2012.

**PËR
KOMISIONERIN PËR MBROTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

**KOMISIONERE
IRMA BARAKU**



**PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË**

**MINISTRI
EDUARD HALIMI**

